
TË DREJTAT E NJERIUT NË KONFLIKTET E ARMATOSURA

E DREJTA NDËRKOMBËTARE HUMANITARE: EDHE LUFTËRAT KANË KUFIJ

..aktet në vazhdim janë dhe duhet të mbeten të ndaluara në çdo kohë, në çdo vend, çfarëdoqoftë [...]

- *Dhuna mbi jetën dhe personin, në veçanti vrasjet e të gjitha llojeve, gjymtimi, trajtimi mizor dhe tortura;*
- *Marrja e pengjeve;*
- *Cenimi i dinjitetit personal, në veçanti trajtimi poshtërues dhe degradues;*
- *Dënimi dhe ekzekutimi pa aktgykim të dalë nga gjykata e rregullt, duke dhënë të gjitha garancitë juridike [...]*
- *Të plagosurit dhe të sëmurët duhen mbledhur dhe duhet kujdesur për ta.*

NENI 3 (1) DHE (2), UNIK PËR TË KATËR KONVENTAT E GJENEVËS TË VITIT 1949

TREGIM ILUSTRUES

Isha 19 vjeç kur shkova në Vietnam. Isha specialist i rangut të katërt i pushkës. Isha i ushtruar për të vrarë, por realiteti për vrasjen e dikujt është ndryshe nga ushtrimet dhe tërheqja e këmbëzës.

Nuk e dija se do ta bëja këtë. Unë e dija se kishte gra dhe fëmijë, por të thosha se do t'i vrisja ata, nuk e dija se do të bëja, deri sa ndodhi. Unë nuk e dija se do të vrisja ndokë. Nuk dëshiroja ta vras askë. Nuk isha i edukuar për të vrarë.

Ajo po vraponte me shpinën e kthyer nga drunjtë, por bartte diçka. Unë nuk e dija se a ishte armë apo diçka tjetër. E dija se është grua, dhe nuk doja që të qëlloja kundër një gruaje, por më urdhëruan të shtija. Dhe, unë mendoja se ajo vraponte me armë dhe e

qëllova. Kur e ktheva përpara, ishte një foshnje. Unë shtiva rreth katër herë në të dhe plumbat kishin kaluar nëpër trupin të saj, duke e qëlluar edhe fëmijën. Dhe, kur e ktheva atë, e pashë fytyrën e foshnjës që ishte përgjysmuar. Unë u zverdha. Ushtrimi erdhi tek unë- programimi për të vrarë- dhe unë fillova të vras.

Varando Simpson, veteran Amerikan i luftës së Vietnamit, duke rrëfyer ngjarjet që kanë ndodhur në vitin 1968.

BURIMI:

MARRË NGA DAVID DONNOVAN, NJË HERË MBRET I LUFTARËVE: KUJTIMET E NJË OFICERI NË VIETNAM, I KUOTUAR NË TE DREJTEN HUMANITARE TË NJOHUR, MODULET E EDUKIMIT PËR TË RINJË, ICRC 2001.

PYETJET PËR DISKUTIM

1. Pse ky ushtar ka shtënë, edhe pse ka ditur se gratë dhe fëmijët nuk janë caqe të arsyeshme?
2. Pse mendoni se gratë dhe fëmijët janë persona të mbrojtur gjatë konflikteve të armatosura?
3. A mendoni se bindja luan rol gjatë luftimeve? A duhet që ushtarët gjithmonë t'i ndjekin urdhërat?
4. Kush mendoni ju se vendos se çka është sjellje ligjore dhe çka joligjore në luftë?
5. Sa e rëndësishme është sipas jush për ushtarët që të mësojnë se çka është e jashtëligjshme? Ç'është qëllimi i pasjes së rregullave?
6. Si mendoni se tragjeditë si ajo e përshkruara më lart mund të parandalohen?

Duke ditur[...]

se i vetmi synim i legjitimuar për të cilin shtetet duhet të përpiqen gjatë luftës është që t'i dobësojnë forcat ushtarake të armikut;

për këtë qëllim është e mjaftueshme për të bërë të paaftë numrin më të madh të mundshëm të meshkujve;

që ky synim do të jetë i tejkaluar me përdorimin e armëve të cilat padobishëm ashpërsojnë vuajtjet e njerëzve të paaftë, apo e bëjnë të paevitueshme vdekjen e tyre.

PREAMBULA E DEKLARATËS SË SHËN PETERSBURGUT, 1868

E DOMOSDOSHME TË DIHET!?

1. EDHE LUFTËRAT KANË KUFIJ

Disa situata e kërcënojnë sigurinë njerëzore më shumë sesa ato të luftës. Në rrethana ekstreme të konfliktit të armatosur, qeveritë e gjejnë vetveten në pozitë të marrjes së vendimeve të vështira në mes të një situatë të nevojave të shoqërisë dhe atyre individuale. Të drejtat e njeriut pushojnë të jenë aktuale, por dhuna sistematike dhe e organizuar, si veçori e vërtetë e konflikteve të armatosura, përbën fyerje për parimet e thella të këtyre të drejtave. Si e tillë, situata e konfliktit të armatosur kërkon një pako rregullash plotësuese të veçanta, duke u bazuar në një ide të thjeshtë, e cila është se **edhe lufta ka kufij**. Këto rregulla zakonisht përmenden si e Drejta Ndërkombëtare Humanitare (DNH) apo E Drejta në Konfliktet e Armatosura. DNH-ja mund të përmblihet si parime dhe rregulla që rregullojnë kufirin e përdorimit të dhunës gjatë konflikteve të armatosura në mënyrë që të:

- kursejë njerëzit ('civilët') indirekt të kyçur në armiqësi
- kufizojë efektet e luftës (edhe të 'luftëtarët') në sasinë e nevojshme për qëllimin e luftës

DNH dhe Siguria Njerëzore

Shumë njerëz e kanë vënë në dyshim dhe shumë të tjerë kanë mohuar se ligji mund ta rregullojë sjelljen në një realitet të përjashtuar, anarkik dhe të dhunës të konfliktit të armatosur. Si mund të pritet se ku mbijetesa e individit apo shoqërisë është në majë, konsiderata juridike do ta kufizojnë sjelljen e njeriut? Sado që do të duket befasuese në shikim të parë, ka arsye shumë të mëdha për agresorët dhe mbrojtësit që njëlloj t'i

ndjekin rregullat e vëna nga DNH. Ndërsa, shpërthimi i dhunës anulon idenë për siguri, megjithatë është me rëndësi të kuptohet se DNH i kontribuon sigurisë njerëzore, duke e mbrojtur idenë se edhe luftërat kanë kufij. DNH njeh realitetin e konflikteve të armatosura dhe u përgjigjet në mënyrë pragmatike, me rregulla të detajuara dhe praktike drejtuar individëve. Kjo degë e ligjit nuk tenton të përcaktojë se çka ka apo *nuk* ka të drejtë shteti apo grupi i rebeluar gjatë konfliktit të armatosur. Më shumë synon që t'i kufizojë vuajtjet që lufta mund t'i shkaktojë. Në orvatjet për të ruajtur dinjitetin njerëzor, DNH mund të thotë po ashtu se i kontribuon një paqeje eventuale, duke i rritur mundësitë e pajtimit.

Lufta gjithmonë duhet të zhvillohet me një vizion për paqe.

HUGO DE GROOT (GROTIUS)

Origjina e DNH

Ndonëse dijetarët mendojnë se DNH-ja moderne lindi më 1864, me miratimin e Konventës së Parë të Gjenevës, është e qartë se rregullat përmbajtëse të Konventës nuk ishin tërësisht të reja. Në realitet, një pjesë e madhe e Konventës së Parë të Gjenevës kishte rrjedhur nga e drejta ekzistuese zakonore ndërkombëtare. Në fakt, kishte rregulla të cilat mbronin kategori të caktuara të viktimave në konflikte të armatosura, dhe zakonet e lidhura me mendimet dhe metodat e luftës së autorizuar apo të ndaluar gjatë armiqësisë, më herët se viti 1000 para Krishtit.

Deri në mesin e shekullit XIX, kodet dhe zakonet të cilat e bënë DNH kanë qenë gjeografikisht të kufizuara dhe nuk kanë shprehur një koncensus universal. Nxitja e parë për traktatin e parë universal mbi të Drejtën Humanitare, në masë të madhe, erdhi nga ndërmarrësi zviceran Henry Dunant. Duke qenë dëshmitarë i kërdisë së bërë në Solferino më 1859, gjatë një beteje, me ç'rast forcat franceze dhe austriake iu kundërvunë njëra-tjetrës në Italinë veriore, Dunant vendosi ta shkruajë një libër në të cilin ai përshkruante tmerrin e betejës dhe mendohej që të sygjeronte dhe të publikonte masat për përmirësimin e fatit të viktimave të luftës. Miratimi i Konventës së Gjenevës së vitit 1864 për Korigjimin e Kushteve të të Plagosurve në Ushtri në terren, përfundoi në një traktat

ndërkombëtar të hapur për ratifikim universal, në të cilin shtetet pranonin vullnetarisht që ta kufizonin fuqinë e tyre në të mirë të individit. Për herë të parë, konfliktet e armatosura u bënë të rregulluara me shkrim në një ligj të përgjithshëm.

DNH si e drejtë ndërkombëtare

Rregullat dhe parimet e DNH janë rregulla juridike të njohura përbotshëm e nuk janë vetëm norma morale dhe filozofike apo zakone shoqërore. Konkluzioni i natyrës juridike i këtyre rregullave është, natyrisht, ekzistimi i një regjimi të detajuar të të drejtave dhe detyrimeve të ngarkuara mbi palë të ndryshme në një konflikt të armatosur. Individët të cilët nuk i respektojnë rregullat e DNH do të sillen para drejtësisë.

E drejta ndërkombëtare humanitare duhet të kuptohet dhe analizohet si një pjesë e veçantë e një kornize tërësore: rregullat dhe parimet të cilat rregullojnë koordinimin dhe kooperimin në mes të anëtarëve të bashkësisë ndërkombëtare, në veçanti, E Drejta Ndërkombëtare Publike.

Kur dielli lindi në njëzetë e pesë qershorin e vitit 1859 shpalosi pamjet më lemeritëse të përfytyruara ndonjëherë. Trupa të burrave dhe kuaj mbulonin fushëbetejën: kufomat ishin të shtruara mbi rrugë, kanale, përroska, shkurre dhe fusha... të gjerët burra të plagosur që barteshin tërë ditën ishin shpirtërisht të dobët dhe të lodhur. Disa prej të lënduarve shumë keq, kishin një shikim të mpirë, ndonëse ata nuk mund ta kapnin se çka u thuhej... Të tjerët ishin të shqetësuar dhe të ngacmuar nga forca e nervozës dhe dridheshin nga fërgëllimet e ngërçeve. Disave, që kishin plagë të hapura, tashmë kishin filluar t'iu shfaqeshin infeksionet, ishin gati të çmendeshin nga vuajtjet. Ata luteshin që t'iu shkurtoheshin vuajtjet, dhe përpërliteshin me fytyrat e tyre të çrregulluara në shtrëngimin e luftës për vdekje.

HENRY DUNANT, KUJTIMET E SOLFERINOS, KNKK.

DNH dhe të Drejtat e Njeriut

Në orvatjet për t'i kufizuar vuajtjet dhe dëmin e shkaktuar nga konflikti i armatosur, DNH mund të thuhet se mbron “thelbin” e të drejtave të njeriut në konflikt. Këta mbrojtës të thelbit, përfshijnë të drejtën për jetë, ndalimin e skllavërisë, ndalimin e torturës dhe të trajtimeve jonjerëzore, si dhe ndalimin e zbatimit të çdo ligji prapaveprues. Ndryshe nga gjërat e tjera (si është liria e të shprehurit, lëvizjes dhe shoqërimit), të cilat mund të shfuqizohen në kohët e gjendjeve të jashtëzakonshme, mbrojtja e thelbit, e dhënë nga DNH kurrë nuk mund të suspendohet. Pasi që DNH aplikohet në situata të veçanta të cilat i përbëjnë konfliktet e armatosura, përmbajtja e “thelbit” të të drejtave të njeriut kujdeset që të përputhet me garancitë themelore dhe juridike të dhëna nga ligji humanitar. Këtu janë disa mënyra kur DNH mbron të drejtat themelore në konflikte të armatosura:

- Mbrojtja e ofruar për viktimat e luftës duhet të jetë **pa asnjë diskriminim**;
- Marrëveshja më e madhe e ligjit humanitar i kushtohet **mbrojtjes së jetës**, në veçanti jetës së civiliëve dhe njerëzve që nuk janë të përfshirë në konflikt; DNH po ashtu **kufizon imponimin e dënimit me vdekje**;
- DNH shkon më larg sesa e drejta tradicionale civile për jetën, duke i mbrojtur mënyrat e nevojshme për jetë, e drejtë e cila mund të kategorizohet si një e drejtë ‘ekonomike dhe sociale’ nën ligjin mbi të drejtat e njeriut;
- DNH plotësisht **ndalon torturën dhe trajtimin jonjerëzor**;
- DNH, në mënyrë specifike **ndalon skllavërinë**: robërit e luftës nuk duhet të shihen si një pronë e atyre të cilët i kanë kapur;
- **Garancitë juridike** janë të kodifikuara në Konventën e Gjenevës dhe me Portokolet Shtesë;
- **Mbrojtja e jetës së fëmijës dhe familjes** është qartë e theksuar në LNH: shembujt përfshijnë rregulla për kushtet e internimit të fëmijës dhe rregullat kundër ndarjes së familjes;
- **Respekti për religjion** është marrë parasysh në rregullat lidhur me të burgosurit e luftës, si dhe në zakonet e varrimit.

Kur përdoret DNH?

DNH është i aplikueshëm në dy situata. Me fjalë të tjera, ai ofron dy sisteme të mbrojtjes: një i aplikuar në konfliktet e armatosura ndërkombëtare dhe tjetri i aplikueshëm në

konfliktet e armatosura jondërkombëtare. Para se t'i definojmë këto dy situata të përdorimit, disa fjalë duhet të thuhet për nocionin e 'konfliktit të armatosur,' i cili që nga viti 1949, ka zëvendësuar nocionin tradicional të 'luftës'.

Konfliktet e armatosura ndërkombëtare janë ato në të cilat dy apo më shumë shtete janë ndeshur duke përdorur armët dhe ato shtete në të cilat njerëzit janë ngritur kundër fuqive kolonizuese, okupimit të huaj apo krimeve raciste, zakonisht të thirrura si luftëra për çlirim nacional. Lart dhe pas aplikimit të dokumentave mbi të drejtat e njeriut, këto situata janë subjekt i një vargu rregullash të gjera të DNH, përfshirë edhe ato të shkruarat përpara në Katër Konventat e Gjenevës së vitit 1949 dhe Protokolin Shtesë I.

Rregulla më shumë të kufizuara janë të aplikueshme në konfliktet e brendshme të armatosura. Ato përfshihen në Nenin 3 të përbashkët për Katër Konventat e Gjenevës dhe Protokolin Shtesë II. Neni 3 paraqet standardin më të vogël të humanitetit, kështu që është i aplikueshëm në çdo situatë të konfliktit të armatosur. Sërish, kjo strukturë rregullash është e aplikueshme në ato aspekte të dispozitave të të drejtave të njeriut, që vazhdojnë të aplikohen në situata emergjente.

Në situata të dhunës, duke mos matur intensitetin e konfliktit të armatosur, DNH nuk aplikohet. Në raste të tilla, dispozitat e të drejtave të njeriut dhe legjislacioni i zbatueshëm vendor vendosin për fatin e atyre që janë të përfshirë në aktet e dhunës.

2. DEFINICIONI DHE PËRSHKRIMI I TË DREJTAVE TË MBROJTURA

Cilat janë rregullat themlore të DNH në konfliktet e armatosura?

1. Personat *hors de combat* (I paaftë për luftë) dhe ata që nuk marrin pjesë direkte në armiqësi, janë të titulluar për respekt për jetët e tyre dhe integritetin moral dhe fizik. Ata në të gjitha rrethanat duhet të mbrohen dhe të trajtohen në mënyrë humane, pa dallime armiqësore.
2. Është e ndaluar që të vritet dhe lëndohet një armik i cili dorëzohet, apo që është *hors de combat* (paaftë për luftë).

3. Të plagosurit dhe të sëmurët duhet të mblidhen dhe për ta të kujdeset pala në

konflikt e cila i ka ata nën fuqinë e tyre. Mbrojtja po ashtu mbulon personelin mjekësor, vendvendosjet, transportin dhe pajisjet. Emblema e kryqit të kuq apo e gjysmëhënës është shenja e një mbrojtjeje të tillë dhe duhet të respektohet.

4. Ushtarët e kapur dhe civilët nën autoritetin të një pale armiqësore duhet të respektohen për jetët e tyre, dinjitetin, të drejtën personale dhe për bindjen e tyre. Ata duhet të mbrohen nga të gjitha atket e dhunës dhe represaljet. Ata duhet

ta kenë të drejtën për të komunikuar me familjet e tyre dhe të marrin ndihmë.

5. Gjithkush duhet të mund të përfitojë nga garancitë themelore juridike. Askush nuk duhet të mbahet i përgjegjshëm për një akt të cilit nuk e ka bërë ai. Askush nuk i duhet nënshtruar torturës fizike apo mendore, dënimit trupor apo trajtimit të egër apo degradues.

6. Palët në një konflikt dhe anëtarët e forcave të tyre të armatosura nuk kanë një zgjedhje të pakufishme të metodave dhe mjeteve të luftimit. Është e ndaluar të përdorën armë apo metoda të natyrës së luftës që shkaktojnë humbje të panevojshme apo vuajtje jashtë mase.

7. Palët në konflikt duhet gjatë gjithë kohës të bëjnë dallim ndërmjet popullsisë civile dhe ushtarëve, në mënyrë që ta kursejnë popullatën civile dhe pronën. Gjithashtu nuk duhet të jenë objekt sulmi popullata civile si e tillë, apo personat civilë. Sulmet duhet të drejtohen vetëm kundër objektivave ushtarake.

Lufta nuk është një marrëdhënie e njeriut me njeriun, por një marrëdhënie në mes të shteteve, në të cilën individët vetëm aksidentalisht janë armiq; jo si njerëz, dhe as si qytetarë, por si ushtarë (...). Pasi që qëllimi i luftës është që ta shkatërrojë shtetin e armikut, është e legjitimuar t'i vrasësh mbrojtësit e fundit përderisa ata bartin armë; por posa t'i lëshojnë ato poshtë dhe të dorëzohen, ata pushojnë të qeni armik apo agjent i armikut, dhe përsëri bëhen njerëz, dhe nuk është më e ligjshme që t'u merret jeta.

ZHAN ZHAK RUSO

Shënim: Këto rregulla, të hartuara nga KNKK, përmbledhin thelbin e DNH. Ato nuk kanë autoritet të instrumenteve juridike dhe në asnjë mënyrë nuk kërkojnë që t'i

zëvendësojnë traktatet në fuqi. Ato janë të skicuara me një qëllim që të ndihmojnë promovimin e DNH.

Çka mbron DNH dhe si?

Humaniteti

Duke e ruajtur sferën e humanitetit në zemër të konfliktit të armatosur, e drejta ndërkombëtare humanitare e mban të hapur rrugën e pajtimit dhe kontribuon jo vetëm që të vendoset paqja në mes të ndërluftuesve, por po ashtu, kujdeset për harmoni ndërmjet njerëzve.

INTERPARLIAMENTARY UNION, KONFERENCA E 90-TË, SHTATOR 2003

E drejta humanitare ndërkombëtare mbron **individët** të cilët nuk janë apo më nuk janë duke marrë pjesë në luftime, si civilët, të plagosurit, të sëmurët, robërit e luftës, të mbijetuarit e fundosjes së anijeve, dhe personeli mjekësor dhe religjioz. Mbrojtja garantohe duke i detyruar palët në konflikt që t'u ofrojnë atyre ndihmë materiale dhe t'i trajtojnë në mënyrë njerëzore në të gjitha kohët dhe pa dallime armiqësore. **Vendet dhe objektet** e veçanta si spitalet dhe ambulancat, po ashtu, janë të mbrojtura dhe nuk duhet të sulmohen. DNH përcakton një numër të emblemave dhe shenjave që dallohen lehtë në veçanti emblemat si Kryqi i Kuq dhe Gjysmëhëna e Kuqe të cilat mund të përdoren për identifikimin e njerëzve dhe të vendeve të mbrojtura. Monumentet historike, dhe punët artistike apo vendet e kultit janë po ashtu të mbrojtura. Përdorimi i këtyre sendeve për mbështetje të fushatës ushtarake është rreptësisht i ndaluar. Gjithashtu, **ambienti** është brengë e DNH që ndalon metodat dhe mjetet e betejës, të cilat janë të menduara, apo që mund të pritet të shkaktojnë dëm me shtrirje të gjerë dhe të ashpër mbi ambientin natyror.

Dallimi duhet të bëhet ndërmjet ushtarëve dhe civilëve në sjelljen armiqësore, por edhe në mes të caqeve civile dhe ushtarake. Kjo do të thotë se jo vetëm civilët si të tillë janë të

mbrojtur, por po ashtu, të mirat e nevojshme për ekzistencë (ushqimet, bagëtia, uji për pirje, etj.).

DNH mbron nga **vuajtjet e panevojshme** duke ndaluar përdorimin e armëve efekti i të cilave do të ishte jashtë mase në krahasim me avantazhet ushtarake të parashikuara, siç janë plumbat eksplozues qëllimi i të cilëve është që të krijojnë plagë të pashërueshme. Parimet e **humanitetit, nevojës ushtarake dhe proporcionalitetit** janë vendimtare për të siguruar synimet e mbrojtjes së civilëve kundrejt forcës së rastit apo anësore dhe për të mbrojtur ushtarët nga vuajtja e panevojshme. Nevoja ushtarake është definuar si veprim që i nevojshëm për të mbizotëruar kundërshtarin, dhe ligji është skicuar që t'i marrë parasysh të gjitha. Rezultati është se një pjesë e mirë e ligjit humanitar mund të mos duket shumë 'humanitar' për një avokat të të drejtave të njeriut, por ky ligj e ka përparësinë e të qenit i saktë dhe realist.

Dallimi

Viktimat e konflikteve të tanishme nuk janë thjesht anonim, por vërtet të panumërt (...). E vërteta e tmerrshme është se civilët sot nuk janë vetëm të 'ngujuar në mes të shkëmbimit të zjarrit'. Ata nuk janë aksidentalisht viktimat apo 'humbje të dyanshme' siç e ka efuemizmi (hijeshia/sjellja momentale). Të gjithë, shumë shpesh, janë caqe të qëllimshme.

KOFI ANAN, SEKTRETARI I PËRGJITHSHËM I KOMBEVE TË BASHKUARA

Kush duhet ta respektojë Ligjin Humanitar Ndërkombëtar?

Vetëm shtetet mund të jenë palë për traktate ndërkombëtare dhe ndaj Konventës së Gjenevës së vitit 1949 dhe dy Protokoleve Shtesë të vitit 1977. Prapëseprapë, të gjitha palët në një konflikt të armatosur –qoftë focat e armatosura të shtetit apo forcat rebeluese– janë të kufizuara nga ligji ndërkombëtar humanitar. Në fillim të vitit 2003, gati të gjitha shtetet e botës, 189, për të qenë të saktë– ishin palë të Konventës së Gjenevës të vitit 1949. Fakti se traktet u pranuan nga shumica e vendeve, dëshmon universalitetin e tyre. Deri më tash, 160 shtete janë palë të Protokolit Shtesë, i cili ndërlidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare, deri sa Potokoli Shtesë II ndërlidhet me mbrojtjen e viktimave të konflikteve të armatosura jondërkombëtare, të

cilen e kanë nënshkruar 153 palë shtetërore. Për të verifikuar nëse shteti i juaj është palë në traktate kontaktoni KNKK apo shikoni web faqen e tyre: <http://www.icrc.org>

3. PERSPEKTIVAT NDËRKULTURORE DHE ÇËSHTJET KONTAVERSE

Rëndësia e vetëdijësimit kulturor

Përpjekjet e njeriut për t'i kufizuar brutalitetet e luftës janë universale. Shumë kultura nëpër histori janë munduar që ta kufizojnë përdorimin e forcës në mënyrë që t'i zvogëlojnë vuajtjet e panevojshme dhe ta kufizojnë shkatërrimin. Edhe pse Konventat Filluese të Gjenevës dhe të Hagës nuk kanë qenë universale në zanafillë, pasi ato janë skicuar dhe miratuar nga juristët dhe diplomatët të cilët i kanë takuar kulturës së krishterë evropiane, vlerat themelore të këtyre konventave janë universale. Kjo matje universale DNH kurrë nuk duhet të nënvlerësohet apo harrohet: shumë shpesh respekti dhe zbatimi i rregullave, në fakt do të varet nga themelimi i një korrespondence të qartë në mes traktateve të aplikueshme apo zakoneve dhe traditave lokale.

Vështrimet e kundërta lidhur me aplikueshmërinë e DNH

Derisa parimet e DNH-së, kanë pasur një aprovim kuazi-universal, problemet e zbatimit mund të ngriten si rezultat i ideve konkurrenente të pikës në të cilën manifestimet e dhunës bëhen një konflikt i armatosur. Kualifikimi i konfliktit si i armatosur është me rëndësi primare, siç është edhe kërkesë bazë për DNH-në që të aplikohet. Kur shtetet përballen me aktet e dhunës në territorin e tyre, ato preferojnë që të merren me këto ndodhi brendapërbrenda shtetit. Kjo është kështu, edhe në qoftë se një shtet tjetër është i përzier në probleme. Pranimi se situata e konfliktit të armatosur po merr masë nënkupton pranimin e përgjegjësisë për bartjen e dhunës e cila mund të jetë e vlefshme për mbrojtje nën rregullat e DNH-së, lart dhe pas mbrojtjes bazë të ofruar nga ligji i të drejtave të njeriut. Autoritetet qeveritare jo befasisht dëshirojnë t'i karakterizojnë këta guximtarë si kriminelë, banditë apo terroristë, më parë se luftëtarë, si rrjedhojë e shmangies nga rregullat e DNH-së.

Njëra nga mënyrat me të cilat DNH e bën vetveten të pranueshme për shtetet në këto situata është garantimi se aplikueshmëria e rregullave nuk do të negociojë asnjë legjimitet mbi grupet e përfshira në armiqësi. Një qasje realiste dhe pragmatike e DNH është përdorur që t'i mbrojë viktimat e konfliktit pa marrë parasysh anët. Është me rëndësi të

theksohet se DNH është një drejtpeshim ndërmjet koncepteve të konfliktit: nevojës ushtarake në një anë dhe brengave humanitare në anën tjetër.

4. ZBATIMI DHE MONITORIMI

Përfaqësuesit e shteteve janë përballur me vështirësi për fuqizimin e te drejtes në konfliktet e armatosura, dhe ata të cilët kanë skicuar traktatet e DNH-së dhe është dashur që të sajojnë mekanizma specifik për zbatim dhe miratim të mekanizmave të përgjithshëm të së drejtës ndërkombëtare për nevojat e veçanta të viktimave të ëkonfliktetve të armatosura. Fatkeqësisht, mekanizmat e përgjithshme specifike të kombinuara, nuk mund të garantojnë asnjë respekt minimal për individët në konfliktete e armatosura. Kjo mund të arrihet kur trajnimi dhe arsimimi i vetëdijëson të gjithë se armiqtë e konfliktetev të armatosura janë qenie njerëzore që e meritojnë respektin.

Gjerësisht të themi, janë tri lloje strategjish të përdorura nga DNH për të siguruar zbatimin:

- Masat preventive
- Masat që të sigurojnë pajtimin gjatë konflikteve të armatosura
- Masat represive

Masat parandaluese

Shtetet palë të Konventës së Gjenevës - që do të thotë gati të gjitha shtetet e botës - nuk kanë asnjë **detyrim** që të zgjerojnë diturinë e të drejtës humanitare ndërkombëtare, sa më gjerë që të jetë e mundur. Nuk është e mjaftueshme që forcat e armatosura të shtetit të jenë të mësuara me DNH: shoqëria civile dhe rinia duhen, po ashtu, të vetëdijësohen për perspektivën humanitare në konfliktin e armatosur. Përqendrimi i menjëhershëm i DNH është mbrojtja e jetës dhe dinjitetit njerëzor në kohët e luftës; por megjithatë, aty përfshihet edhe mbrojtjea e vlerave të tilla, në të gjitha përvojat tona. Si e tillë, së bashku me mësimin e të drejtave të njeriut, DNH jep një kontribut të veçantë për edukimin qytetar në nivel lokal, nacional dhe internacional. Edukimi dhe trajnimi duhet të fillojnë në kohën e paqes, në mënyrë që të ngulitet në mendje një reflektim i vërtetë humanitar.

>> ne mund të mësojmë se sa lehtë një person, pa marrë parasysh nacionalitetin, mund të kurthohet nga psikologjia e brutalitetit, kur është pjesëmarrës i luftës. Ky brutalitet, shpesh është i shkaktuar nga urrejtja e të tjerëve, siç është i ilustruar qartë në aktete racizmit. Problemi më themelor të cilin ne duhet ta shqyrtojmë kur merremi me ndonjë krim lufte është frika e pakufishme nga vdekja, të cilën e përjetojnë ushtarët. Në mënyrë që ta tejkalojnë frikën gjatë luftës, njerëzit priren që të mbështeten mbi dhunën, e cila si shpagesë e degradon moralin e tyre dhe e shfaq vetveten përmes shpërthimit të brutalitetit. <<

YUKI TANAKA, DIJETAR JAPONEZ

Masat për vështrimin pajtues

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq (KNKK) luan rol të madh duke ua rikujtuar shteteve se duhet të ndërmarrin masat për t'i bërë ligjet humanitare të njohura dhe duhet bërë të gjithë hapat e nevojshëm për të siguruar se ligji është efektivisht i aplikuar dhe plotësisht i respektuar.

Masat represive

Ligji humanitar ndërkombëtar detyron shtetet që t'i pezullojnë të gjitha shkeljet e tyre. Shkeljet e mëdha të të drejtave të njeriut të quajtura krime të luftës janë të sanksionuara nga DNH, që në të vërtetë është kërkesë që shtetet të pasivizojnë legjislacionin vendor për të dënuar krimet e luftës, për kerkimin e njerëzve të cilët gjoja kanë bërë këso krimesh, dhe për t'i sjellë ata para gjyqeve të tyre apo për t'i ekstraduar ata në një shtet tjetër për persekutim. Këto masa represive mund të shërbejnë, po ashtu, si një sigures që parandalon rishfaqjen e shkeljes së të drejtave të njeriut. Bashkësia ndërkombëtare tani ka krijuar një Gjykatë Ndërkombëtare për Krimet (GJNK) e cila do të jetë kompetente për gjykimin e krimeve të luftës, krimeve kundër njerëzimit dhe gjenocidit. Ndryshe nga Tribunalet *ad-hoc* të krijuara për konfliktet në ish-Jugosllavi dhe Ruandë, GJNK ka juridiksion universal.

E DOBISHME TË DIHET

Kryqi i Kuq Ndërkombëtar dhe Lëvizja e Gjysmëhënës së Kuqe përbëhen nga Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq (KNKK), shoqatat nacionale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, të përafërsisht 180 shteteve, dhe Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Shoqatat nacionale veprojnë si ndihmë për autoritetet publike të shteteve të tyre në fushë humanitare dhe ofrojnë një mori shërbimesh, përfshirë këtu ndihmën për katastrofën dhe programet sociale dhe të shëndetësisë. Federata është një organizatë që promovon bashkëpunimin ndërmjet mes shoqërive nacionale dhe forcon fuqinë tyre.

Si mbrojtës dhe promovues i DNH-së, KNKK luan një rol udhëheqës në kërkim të masës së humanitetit në mes të konfliktit të armatosur.

1. PRAKTIKA TË MIRA

Mbrojtja e civilëve

E Drejta humanitare është themeluar mbi parimin e imunitetit të popullsisë civile. Njerëzit që nuk marrin pjesë në armiqësi nuk mund të sulmohen në asnjë situatë; ata duhet të kursehen dhe të mbrohen. Në konfliktet e ditës së sotme, megjithatë, civilët shpesh pësojnë dhunë të tmerrshme, nganjëherë si caqe direkte. Masakrat, pengmarrjet, dhuna seksuale, shqetësimi, dëbimi, transferi dhe grabitja me forcë, mohimi i qëllimshëm i qasje për ujë, ushqim, dhe kujdes shëndetësor, janë disa nga praktikat që mbjellin terror dhe vuajtje në mesin e civilëve. KNKK mban një prezencë konstante në rajonet ku civilët janë në rrezik. Vëmendje e posaçme u është kushtuar **grave** dhe **fëmijëve**, për arsye se DNH ofron për ta mbrojtje specifike.

Shpërbërja e familjeve në kohët e luftës i lë gratë dhe vajzat të prekura nga dhuna. Afërsisht 80% e 53 milion njerëzve të zhvendosur nga luftërat janë gra dhe fëmijë. Kur etërit, burrat, vëllezërit dhe djemtë janë tretur larg për të luftuar, ata i lënë gratë, të rinjtë dhe pleqtë që ta mbrojnë vetveten. Familjet në ikje përmendin përdhunimin apo frikën nga përdhunimi si një faktor kyq në vendimin e tyre për të kërkuar shpëtim..

**MADHËSHTIA E BOTËS JANË
FËMIJËT 1996**

Femra e përjeton konfliktin e armatosur në mënyra të ndryshme – nga pjesëmarrja aktive si luftëtare deri në rastet kur bëhet shënjestër si anëtare e popullatës civile, apo sepse është femër. Përvoja e femrës në luftë është e shumanëshme – ajo nënkupton ndarjen, humbjen e anëtarëve të familjes dhe jetesës, dhe rrezikun në rritje nga dhuna seksuale, plagosja, vuajtja dhe vdekja. Përgjigja ndaj këtij realiteti përfshin:

- Mësimin e mbajtësve të armëve për të drejtat e grave.
- Ofrimi i ndihmës për kujdesin shëndetësor gjinekologjik në komplekse mjekësore dhe vende shëndetësore që u shërbejnë viktimave të armiqësisë.
- Rikujtimi i autoriteteve të paraburgimit, se femrat e paraburgosura duhet të vihen nën mbikëqyrje të menjëhershme të femrave dhe se dhomat e fjetjes dhe mjetet, duhet të jenë të ndara nga ato të meshkujve.
- Puna për rivënien e kontaktetve në mes anëtarëve të familjes të cilët ishin ndarë si rezultat i konfliktit.
- Ofrimi i mbështetjes për familjet e të zhdukurve.

Fëmijët shumë shpesh janë dëshmitarët e parë të krimeve të bëra kundër prindërve të tyre apo anëtarëve të tjerë të familjes. Ata janë vrarë, gjymtuar, burgosur apo në raste të tjera janë ndarë nga familjet e tyre. Largimi nga ambienti familjar për ta, edhe për ata të cilët arritën të ikin nga kjo gjendje, shkakton mungesën e çdo sigurie për ardhmërinë e tyre dhe për ardhmërinë e të dashurve të tyre. Ata shumë herë janë detyruar të ikin duke braktisur gjërat e tyre dhe refuzohen pa ndonjë dallim. Veç kësaj, fëmijët që jetojnë me familjet e tyre apo që janë lënë vetë në zonat e konfliktit, janë kandidatë potencialë për rekrutim si ushtarë. Të rrëmbyer nga familja, këta rekrutë-fëmijë nuk mund ta paramendojnë jetën pa luftë. Bashkimi me një grup të armatosur është mënyrë që ta sigurojë mbijetesën e tyre. Përgjigja ndaj këtij realiteti përfshin:

- Promovimi i respektimit të të drejtave të njeriut të bartësit e armëve
- Ndjekja e rekrutimit dhe e pjesëmarrjes së fëmijëve në konflikt të armatosur.
- Dhënia e fëmijëve-viktima me asistencë mjekësore, psikologjike dhe sociale.

- Puna për rivendosjen e kontakteve familjare, duke ofruar ndihmë për fëmijët e vetmuar dhe duke kërkuar personat e zhdukur.
- Monitorimi i kushteve të arrestit për fëmijë – sigurimi se ata mbahen ndaras nga të rriturit, përveç nëse janë anëtarë të familjes së njëjtë – dhe puna që sjell lirimin e fëmijëve.

Ka fëmijë të cilët u bashkohen të ashtuquajturave arsye vullnetare. Por, unë mendoj se njëra duhet të jetë se nuk ka gjë të tillë si bashkimi vullnetar, në kuptim se shumica e madhe e fëmijëve të cilët bashkangjiten me dëshirë për të bërë këtë nga nevoja apo viktimizimi është frika për siguri. Fëmijët jetimë të cilët nuk kanë fare prindër që t'i mbrojnë, njerëz të cilët janë të frikësuar se do të vdesin nga uria apo që nuk kanë shëndet të mjaftueshëm, mund të kërkojnë aktivitet ushtarak.

DR. MIKE WESSELLS

Mbrojta e të burgosurve

Njëra nga pasojat e konfliktit të armatosur është marrja dhe mbajtja e të burgosurve. Privimi nga liria i bën njerëzit të prekshëm përballë autoriteteve ndaluese dhe brenda ambientit të burgut. Kjo prekje apo lëndueshmëri është në veçanti e theksuar në kohët e konfliktit dhe dhunës së brendshme, kur përdorimi i tepruar dhe ilegal i forcës është gjë e rëndomtë dhe pamjaftueshmëritë strukturore janë të keqësuar. DNH përfshin masat që kanë qëllim specifik mbrojtjen e të burgosurve. Mënyrat për të siguruar respekt për jetën dhe dinjtetin e të burgosurit përfshijnë:

- Garantimi se ata të cilët janë në krye të burgut do të pranojnë trajnime për rregullat dhe do të dënohen në qoftë se nuk arrijnë t'i zbatojë këto rregulla.
- Sigurimi se autoritetet sigurojnë fonde dhe mjete të mjaftueshme për burxhet.
- Lejimi i shoqatave neutrale humanitare si KNKK që t'i vizitojë të burgosurit dhe të monitorojë trajtimin e tyre.
- Rivendosja e lidhjeve familjare, aty ku janë shkëputur.
- Mbështetja për organizatat për të drejtat e njeriut si Amnesty International apo Human Rights Watch apo organizatat lokale për të drejtat e njeriut që e

informojnë publikun se çka kanë mësuar për keqtrajtimin e të burgosurve nga kapësit e tyre.

Rivendosja e lidhjeve familjare

Në të gjitha krizat- konfliktet e armatosura, zhvendojet e mëdha të popullsisë, dhe situata të tjera të krizës - fëmijët mbeten të ndarë nga prindërit e tyre, familjet dhe të rriturit e tjerë. Për shkak se statusi i tyre rrallëherë është shumë i qartë, atyre u referohet statusi si 'fëmijë të ndarë apo të vetmuar' më tepër sesa 'jetimë'. Edhe të tjerët, siç janë pleqtë apo të hendikepuarit, mund të jenë në situata të vështira gjatë konfliktit. Ata mund të mbeten mbrapa, të jenë të izoluar, të ndarë nga të afërmit e tyre dhe të paafte qër të kujdesen për vetveten. Për arsye të lëndueshmërisë së tyre, KNKK do të ndër marrë, kur është e nevojshme, masa të veçanta, me qëllim të mbrojtjes së tyre dhe ribashkimit familjar. Disa nga këto masa përfshijnë:

- Avancimin e lajmeve për familje përmes porosive të Kryqit të Kuq, transmetimeve të radios, përmes telefonit dhe internetit, nëpërmjet Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe Lëvizjes së Gjysmëhënës së Kuqe.
- Organizimi i riadhesimit dhe ribashkimit familjar.
- Ndihma për vizita familjare për të afërimit e arrestuar apo përgjatë vijës së frontit.
- Dhënia e dokumentave të udhëtimit të KNKK atyre që falë konfliktit nuk kanë apo nuk kanë më letra identifikuese, dhe janë për riadhesim apo rivendosje në vend të tretë.
- Informimi dhe mbështetja e familjeve të personave të zhdukur.

Një Fjalë për Emblemën

Konventa e Gjenevës përmend tri emblema: Kryqin e Kuq, Gjysmëhënën e Kuqe dhe Luanin e Kuq dhe Diellin, edhe pse vetëm dy të parat përdoren. DNH rregullon përdorimin, madhësinë, qëllimin dhe vendin e emblemës, njerëzit dhe pronën që mbron

ajo, kush mund ta përdorë atë, çfarë respekti detyrohem të kemi për emblemën, dhe çfarë janë dënimet për keqpërdorime.

Në kohët e konfliktit të armatosur, emblema mund të përdoret si mjet mbrojtës vetëm nga:

- Shërbimet mjekësore të forcave të armatosura
- Shoqatat Kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, sipas rregullit të njohura dhe të autorizuar nga qeveritë për dhënie e asistencës në shërbime mjekësore të forcave të armatosura;
- Spitalet civile dhe vendet e tjera mjekësore të njohura si të tilla nga qeveria;
- Agjencione të tjera të ndihmës, subjekt i kushteve të njëjta si Shoqata Nacionale.

Tri tipet e keqpërdorimit të emblemës:

1. **Imitimi:** një organizatë humanitare përdor një kryq të kuq ngatërrues dhe të ngjashëm për ta identifikuar vetveten.
2. **Uzurpimi:** një farmacist prezanton / shpall biznesin e tij/saj me flamurin e Kryqit të Kuq.
3. **Pabesi:** ushtarët përdorin ambulancën që e mban kryqin e kuq për të bartur armë.

Shtetet duhet t'i marrin të gjitha masat për të parandaluar dhe për t'u përmbajtur nga keqpërdorimi i emblemës. Rastet më të rënda të keqpërdorimit trajtohen si krime lufte.

Parimet e punës e veprimit humanitar

Në mënyrë që të kualifikohet si humanitare, një organizatë duhet të pajtohet me një numër parimesh. Parimet më të rëndësishëm të punës janë **neutraliteti** dhe **objektiviteti**. Neutraliteti mund të kuptohet si paanësi. Ky parim i lejon punëtorëve humanitarë që ta fitojnë dhe mbajnë besimin e çdonjërit që është i përfshirë në konflikt. Objektiviteti nënkupton se përparësia do të jepet në bazë të nevojave. Në të vërtetë, punëtorët humanitarë nuk bëjnë dallime në bazë të nacionalitetit, racës, religjionit, klasës shoqërore apo opinionëve politike. Ata janë të udhëhequr vetëm nga nevojat e individëve dhe duhet t'u japin përparësi rasteve më urgjente. Për arsye të natyrës së ndieshme të punës së

KNKK-së, qoftë ajo vizita e të burgosurve apo veprimi ndërmjetësues neutral në mes palëve ndërluftuese, dhe nga që ajo dëshiron të jetë e pranishme, dhe së paku të jetë e toleruar nga të gjitha palët, **mirëbesimi** luan një rol të rëndësishëm në punën e organizatës. Ky parim, bashkë me neutralitetin dhe objektivitetin ngre dilemë etike për punëtorët humanitar të cilët nuk mund të denoncojnë shpërdorimet të cilat i shohin gjatë punës së tyre, sepse mund ta vënë në rrezik jetën e viktimave apo të vështirësojnë mundësinë për të hyrë te ata që kanë nevojë për ndihmën e tyre.

Parimet fundamentale të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

Humaniteti – mbrojtja e jetës, shëndetit dhe sigurimi i respektit për qeniet njerëzore.

Objektiviteti - asnjë diskriminim sa i përket nacionalitetit, racës, religjionit, opinionëve klasorë apo politike: udhëhequr vetëm nga nevojat.

Neutraliteti - nuk duhet të mbahet ana në armiqësi.

Pavarësia - autonomi e plotë nga të gjitha llojet e autoritetit të jashtëm.

Shërbimi vullnetar – organizata joprofitabile.

Uniteti – mund të jetë vetëm një shoqëri e Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në çfarëdo shteti.

Univesaliteti – organizatë botërore.

2. TRENDET

Tabela në faqen 221 të librit.

Ndalimi i minave antikëmbësorike

Gjatë viteve të '90 Kryqi i Kuq Ndërkombëtar dhe Lëvizja e Gjysmëhënës së Kuqe, organizatat ndërkombëtare dhe koalicioni i gjerë i OJQ-ve kanë punuar për ndalimin e minave antikëmbësorike, dhe për të ndihmuar viktimat e minave dhe komunitetet e dëmtuara nga minat. Kjo punë u kurorëzua më 1997 me miratimin e Traktatit të Otavës, *Konventa për Ndalimin e Përdorimit, Magazinimit, Prodhimit dhe Transferit të Minave Antikëmbësorike dhe mbi shkatërrimin e tyre*, e cila hyri në fuqi më 1 mars 1999. Është konventa e parë që ndalon, nën ligjin ndërkombëtar humanitar, një armë që përdoret gjerësisht, dhe është bërë ligj më shpejt sesa çdo marrëveshje multilaterale për armët.

Rrjeti Humanitar i Sigurisë u shfaq dhe u konsolidua si rezultat i procesit të përgatitjes dhe miratimit të Konventës së Otavës. Pjesëmarrja shpjegon prioritetet e agjendës së RRHS, dhe angazhimin e shteteve anëtare të RRHS për reduktimin e armëve të vogla dhe ndalimin e minave fushore.

Deri në dhjetor të vitit 2002, 130 shtete e kanë ratifikuar Traktatin e Ndalimit të Minave, dhe 16 shtetë shtesë e kanë nënshkruar atë. Shtetet anëtare të Rrjetit Humanitar të Sigurisë ishin ithtarët më të zjarrtë të traktatit, duke e udhëhequr koalicionin ndërkombëtar për zbatimin e plotë dhe në kohë të traktatit.

Disa statistika të ndihmës së KNKK për vitin 2001

Vizita të burgjeve

346,807 të arrestuar ishin vizituar në **1,998** vendarreste në mbi **70** vende, përfshirë 24,479 të arrestuar të cilët ishin regjistruar dhe vizituar për herë të parë. 70,164 njerëz vizituan një të afërt të burgosur me ndihmën e KNKK. 32,815 certifikata të arrestimeve janë lëshuar.

Rivënia e lidhjeve familjare

447,004 porosi të Kryqit të Kuq ishin mbledhur

418,461 porosi të Kryqit të Kuq ishin shpërndarë

1,897 njerëz, familjet e të cilëve kishin bërë kërkesa për gjetje ishin gjetur

1,662 njerëz ishin ribashkuar me familjet e tyre

7,463 njerëz ishin pajisur me dokumente udhëtimi për t'i lejuar ata që të kthehen në shtëpi apo të vendosen diku tjetër.

Ndihma

1,000,000 njerëz kishin marrë ndihmë direkte dhe asistencë mujore ishte ofruar për mesatarisht **320,000** njerëz të zhvendosur brenda shteteve dhe për **260,000** të popullatës rezidente.

96,000 njerëz të privuar nga liria e tyre kanë marrë asistencë direkte, me gjithsej 135,000 tonë ushqime, rroba, batanije, tenda etj.. po ashtu 29 milion franga zvicerane, sasi e materialeve mjekësore, sanitarisë, dhe ortopedisë ishin shpërndarë në 60 vende.

3. KRONOLOGJIA

Disa konflikte të armatosura kanë pasur më shumë ose më pak ndikim të menjëhershëm në zhvillimin e ligjit humanitar.

Lufta e Parë Botërore (1914-1918) ka dëshmuar se përdorimi i metodave të luftës ishte nëse jo komplet, së paku i shpërndarë në përmasa të gjera. Këtu përfshihen gazrat helmuese, bombardimet e para nga ajri dhe kapja e qindra mijëra të burgosurve. Si përgjigje për këto zhvillime u nënshkrua traktati i vitit 1925 i cili ndalon përdorimin e disa metodave të luftës dhe traktatet e vitit 1929 që merren me trajtimin e të burgosurve të luftës.

Lufta e Dytë Botërore (1939 – 1945) shfaqti shifra të njëjta të civilëve dhe të ushtarëve të vrarë, kundrejt shifrës 1:10 në Luftën e Parë Botërore. Më 1949, bashkësia ndërkombëtare iu kundërvu këtyre shifrave tragjike, dhe më konkretisht të themi efekteve të tmerrshme që kishte lufta mbi civilët, duke i rishikuar konventat që ishin në fuqi atëherë dhe duke miratuar një instrument të ri: Katër Konventat e Gjenevës për mbrojtjen e civilëve.

Në vitin 1977, Protokolet Shtesë ishin përgjigje ndaj sfidave të reja për mbrojtje në luftërat dekolonizuese, si dhe zhvillimit të teknologjisë së re ushtarake. Veçmas, Protokoli Shtesë II, përfshin forcat e armatosura disidente apo grupe të tjera të organizuara të armatosura, të cilat nën një komandë të përgjegjësive, ushtrojnë kontroll mbi një pjesë të territorit.

Instrumentet bazë të DNH dhe instrumentet e tjera të ndërlidhura

1864: Konventa e Gjenevës për përmirësimin e kushteve për të plagosur në armatat në terren.

1868: Deklarata e Shën Petersburgut (ndalimi i përdorimit të predhave të veçanta në luftë)

1899: Konventa e Hagës për respektimin e ligjeve dhe zakoneve të luftës në tokë dhe adaptimi për beteja detare i Konventës së Gjenevës së vitit 1864.

1906: Rishikimi dhe zhvillimi i Konventës së Gjenevës së vitit 1864.

1907: Rishikimi i Konventës së Hagës së vitit 1899 dhe miratimi i konventave të reja.

1925: Protokoli i Gjenevës për ndalimin e përdorimit në luftë të helmeve vdekjeprurëse apo gazrave të tjera dhe metodave bakteriologjike të luftës.

1929: Dy Konventat e Gjenevës:

- Rishikimi dhe zhvillimi i Konventës së Gjenevës së vitit 1906
- Konventa e Gjenevës për trajtimin e të burgosurve të luftës (e re)

1949: Konventat e Gjenevës:

I Përmirësimi i kushteve për të plagosurit dhe të sëmurët në fushbetejë në konfliktet e armatosura

II Përmirësimi i kushteve për të plagosurit, të sëmurët dhe të përbyturit e forcave të armatosura në det

III Trajtimi i robërve të luftës

IV Mbrojtja e personave civilë në kohë lufte (e re)

1954: Konventa e Hagës për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore në kohë të konfliktit të armatosur

1972: Konventa mbi ndalimin e zhvillimit, prodhimit dhe ruajtjes së armëve bakteriologjike (biologjike) dhe toksike, si dhe për shkatërrimin e tyre.

1977: Dy protokolet shtesë për Katër Konventat e Gjenevës të vitit 1949, të cilat forcuan mbrojtjen e viktimave të konflikteve ndërkombëtare (Protokoli I) dhe ndërkombëtare (Protokoli II)

1980: Konventa për ndalimin apo zvogëlimin mbi armët e veçanta konvencionale, për të cilat mendohet se kanë efekte jashtë mase apo të rrëmujujshëm (KAK), e cila përfshinë:

- Protokolin (I) mbi pjesët e pazbulueshme
- Protokolin (II) mbi ndalimin apo kufizimin e përdorimit të minave, grackave shpërthyesë dhe mjeteve të tjera të këtij lloji

- Protokolin (III) mbi ndalimin apo kufizimin e përdorimit të armëve ndezëse
- 1993:** Konventa për ndalimin e zhvillimit, prodhimit, ruajtjes dhe përdorimit të armëve kimike dhe mbi shkatërrimin e tyre
- 1995:** Protokoli lidhur për armët verbuese laserike (Protokoli IV (i ri (i Konventës së vitit 1980)))
- 1996:** Protokoli i Korrigjuar mbi ndalimin dhe kufizimin e përdorimit të minave, grackave shpërthyes, dhe mjeteve të tjera të këtij lloji (Protokoli II (i korrigjuar (i Konventës së vitit 1980)))
- 1997:** Konventa për ndalimin e përdorimit, ruajtjes, prodhimit dhe transferit të minave antikëmbësorike dhe mbi shkatërrimin e tyre
- 1998:** Statuti i Romës për Gjykatën Ndërkombëtare të Krimeve
- 1999:** Protokoli shtesë për Konventën e vitit 1954 për trashëgiminë kulturore
- 2000:** Protokoli Fakultativ për Konventën mbi të drejtat e njeriut të fëmijëve, që merret me përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura
- 2001:** Amandamenti i Nenit 1 të KAK
- 2002:** Hyrja në fuqi e Statutit të Romës, duke themeluar Gjykatën e parë Ndërkombëtare të Përhershme të Krimeve
- 2002:** Hyrja në fuqi e Protokolit Fakultativ për Konventën mbi të drejtat e njeriut të fëmijëve, që merrret me përfshirjen e fëmijëve në konfliktet e armatosura

BURIMI:

HULUMTIMI I LIGJIT HUMANITAR, MODULET EDUKATIVE PËR TË RINJ, KNKK 2002

ATIVITETE TE ZGJEDHURA

AKTIVITETI I:

PJESA I: HYRJA

Për shumë njerëz, ideja se mund të ketë rregulla në luftë duket absurde, sepse ata besojnë se vetë ideja e luftës është një kontradiktë e nocionit të ligjit apo të drejtave të njeriut. Por është fakt se shumica e vendeve në botë pranojnë dhe fusin në fuqi rregullat e DNH. Pse është kështu? Në një diskutim të propozuar, pjesëmarrësve do t'u parashtrihen disa

pyetje të cilat do t'u ndihmojnë atyre për të punuar në disa nga arsyet kryesore që shtetet pajtohen me obligimet e tyre humanitare në kohën e konfliktit të armatosur.

Lloji i aktivitetit: diskutim

Pyetjet për diskutim:

1. Nëse jam duke e fituar luftën, pse duhet t'u bindem rregullave që kufizojnë sjelljen time?
2. Nëse këto rregulla shkilen gjatë gjithë kohës, pse na duhen ato?
3. A do të na duhet DNH duke marrë parasysh të gjitha instrumentet e të Drejtave të Njeriut që ekzistojnë?
Pse shtetet nuk e bëjnë më të vështirën dhe t'i suspendojnë obligimet e të drejtave të tyre të njeriut gjatë kohës së luftës?
4. Si mund të pretendojë DNH se bën përmirësimin e kushteve për paqe dhe sigurinë njerëzore nëse e pranon realitetin e luftës?

PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Synimet

- Për të kuptuar disa nga arsyet pse rregullat janë të nevojshme në konflikte të armatosura
- Për t'u vetëdijësuar për çështjet e vështira që janë ngritur nga ideja e DNH
- Për t'u bërë më të afërt me arsyet për të cilat shtetet e respektojnë DNH
- Për të kuptuar plotësimin e ndërsjellë ndërmjet ligjit të të drejtave të njeriut dhe DNH
- Për t'i njohur disa rregulla themelore të DNH

Grupi i synuar: të rinjtë, të rriturit

Madhësia e Grupimit / organizmi shoqëror: në mes 12 dhe 20 vetë

Koha: 90 minuta

Përgatitja dhe Materiali:

- Shpërndaj kopje të rregullave themelore të DNH si dhe grafoskopin, i cili tregon plotësimet e DNH dhe dispozitave të Drejtave të Njeriut
- Duhet të ketë tabelë mbi të cilën duhet shkruar disa ide kryesore që kanë lindur gjatë diskutimit
- Shpërndaj pyetjet për diskutim një javë apo disa ditë para aktivitetit, në mënyrë që pjesëmarrësit të kenë mundësi të mendojnë për to dhe të diskutojnë ndërmjet vete apo me shokët dhe me familjen.

Aftësitë e përfshira:

- Aftësia për zhvillimin e argumentit
- Aftësia e të menduarit kritik
- Aftësia për komunikim efektiv
- Aftësia për menaxhim e mendimeve të kundërta

PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE

Hyrje në temë

Ky diskutim adreson disa pyetje shumë të vështira për të cilat nuk ka përgjigje të lehta. Pjesëmarrësit duhet të inkurajohen të mendojnë në mënyre kreative dhe kritike, dhe nuk duhet ta humbin kohën duke kërkuar për përgjigjen e *drejtë*. Duhet, po ashtu, që përgjigjet kritike të mos injorohen, sepse qëllimi i aktivitetit është që pjesëmarrësit të zbulojnë që shtetet janë të nxitura t'i respektojnë DNH mbi dhe përtej arsye morale dhe legale për ta bërë këtë. Komentet cinike mund të përdoren për t'i nxjerrë në pah këto nxitje dhe të demonstronë natyrën pragmatike të DNH.

Procesi i diskutimit

Pjesëmarrësit ndahen në katër nëngrupe dhe çdo nëngrup ka për detyrë një të një nga katër pyetjet e diskutimit. Grupet i kanë nga tridhjetë minuta për diskutim, gjatë të cilave instruktori mund të ndërhyjë dhe të ndihmojë duke vënë në pah çështjet e poshtëshënuara. Çdo nëngrup duhet ta emërojë një *raportues* që t'i raportojë pjesës tjetër të grupit pas përfundimit të tridhjetë minutave. Për orën e mbetur, hapet biseda për të gjithë grupin që të diskutohet çdo pyetje, duke marrë parasysh atë që *raportuesit* kanë thënë.

Pyetja 1

- Mendo për interesin afatgjatë të vendit
- Çka në qoftë se ana juaj fillon ta humbë luftën?
- Cili është roli i opinionit publik?

Pyetja 2

- Mos vallë pajtimi me rregullat është një lajm i ri?
- Si mund ta dimë që rregullat shkilen gjithmonë?
- Edhe respektimi i pjesshëm i rregullave mund të ofrojë mbrojtje për disa njerëz.
- Çka nëse sanksionet janë të aplikueshme më fort për shkelje të rregullave?

Pyetja 3

- Mendo disa arsye të mira për pezullimin e disa të drejtave në kohë të konfliktit të armatosur!
- A i mbron të drejtat e njeriut DNH?
- A mund të kërkoni nga ushtarët që të respektojnë të drejtën për jetë kur ata luftojnë?
- A thonë diçka instrumentet e të drejtave të njeriut për mjetet dhe metodat e luftës?

Pyetja 4

- Kur të përfundojë konflikti, a mendoni që palët do të harrojnë atë që është bërë gjatë armiqësisë?
- A mund t'i kontribuojë paqes parandalimi i një shkatërrimi gjithëpërfshirës?
- Mendoni për masat represive të cilat mund të përdoren për të siguruar drejtësinë pas konfliktit. Si kontribuojnë këto masa për paqen? Apo nuk kontribuojnë fare?

Vlerësim

Dhjetë minuta në fund të sesionit duhet t'i kushtohen vlerësimit të marrë nga grupi se çka u ka pëlqyer e çka jo lidhur me diskutimin. Në qoftë se janë bërë pyetje të tjera gjatë diskutimit, ato duhen shënuar në tabelë dhe, ndoshta, duhen përdorur për diskutime të ardhshme.

Këshilla metodologjike:

Nxiti studentët që të shkojnë përtej idesë se çka është mirë e çka është gabim dhe orientoi ata drejt zbulimit se përse është në interes të shteteve respektimi i DNH.

Sygjerime për ndryshim

Pas përfundimit të diskutimit në nëngrupe, organizo një akt dramatik në të cilin çdo grup ka 10 minuta që t'i përdorë përgjigjet në mënyrë që t'i bindin qeveritë e tyre për ratifikimin e traktateve të DNH. Një pjesëmarrës mund ta luajë rolin e Kryetarit të Shtetit të supozuar i cili nuk e sheh qëllimin e DNH.

PJESA IV: VAZHDIMI

Shiko lajmet botërore në një gazetë ditore dhe identifikoj shkeljen e DNH që është bërë në konflikte të ndryshme. A e pranojnë këtë mediat dhe Kombet e Bashkuara si fakt të luftës, apo vëreni se është dënuar një sjellje e tillë?

Fusha të tjera të hulumtit

Përbushja e të drejtave të njeriut dhe DNH.

BURIMI

HULUMTIMI I TË DREJTËS HUMANITARE, MODULET EDUKATIVE PËR TË RINJ, KNKK 2002, FQ.93.

2 AKTIVITETI II: ETIKA E VEPRIMEVE HUMANITARE

PJESA I: HYRJE

Dilema etike mund të definohet si një situatë ku kërkimi i një qëllimi të vlefshëm bie ndesh me një qëllim tjetër të vlefshëm dhe çon të lëndimi si dhe tek e mira. Punëtorët humanitarë shpesh përballen me dilemat etike gjatë punës së tyre. Si rezultat i kësaj, në përgjithësi shumë kritika u janë drejtuar veprimeve humanitare. Është me rëndësi të kuptohet se cilat lloje të dilemave janë përfshirë në ofrimin e asistencës humanitare dhe të diskutohet se a ekzistojnë alternativa të qëndrueshme. Në aktivitetin e propozuar,

pjesëmarrësit duhet t'i analizojnë situatat të cilat prezantojnë një dilemë etike dhe të vendosin se çfarë veprimi do të ndërmarrin. Duke bërë kështu, ata, po ashtu, do të ndërtojnë argumentet për mohim dhe kritikë.

Lloji i aktiviteti: rast për studim

PJESA II: INFORMATA TË PËRGJITHSHME

Synimet:

- Njoftimi me parimet të cilat udhëheqin veprimin humanitar, siç janë ato të neutralitetit dhe objektivitetit
- Të kuptojmë disa nga dilemat me të cilat mund të përballen punëtorët humanitar gjatë punës së tyre
- Të kuptojmë se edhe në situata jofituese, punëtorët humanitarë nuk mund t'i shmangen marrjes së vendimeve: mosveprimi është po aq zgjedhje sa edhe marrja e disa veprimeve specifike

Grupi i synuar: të rinjtë, të rriturit

Madhësia e Grupimit / organizmi shoqëror: prej 12 deri 20 vjet

Koha: 60 minuta

Përgatitja dhe materiali:

Shpërdani kopje për rastet e poshtëshënuara dhe vini pyetjet që ilustrojnë çdo situatë, në një vend ku mund t'i shohin të gjithë.

Aftësitë e përfshira:

- Shkathësia për ta parë problemin nga këndvështrime të ndryshme
- Shkathësia për të zhvilluar mendimin personal
- Shkathësia për të zgjidhur disa probleme
- Shkathësia për të mirëkuptuar ndjenjat dhe përvojat e një personi tjetër

PJESA III: INFORMATA SPECIFIKE

Hyrje në temë

Pyetni nëse ndokush ka njohuri për kodet e veçanta të drejtimit të cilat lidhen me mënyrën e sjelljes së njeriut gjatë punës në profesionet e tyre. Përgjigja mund të përfshijë rregullat dhe detyrat të cilat duhet t'i ndjekë mjeku apo kodi i etikës së gazetarisë që i parandalon ata që të zbulojnë emra të njerëzve të cilët ua kanë ofruar informatën në qoftë se ajo mund t'ua rrezikojë informatorët apo dëshira e tyre për intimitet. Rishikoni pjesën e modulit të titulluar “Parimet e Punës së Veprimit Humanitar” dhe sigurohuni që pjesëmarrësit t'i kuptojnë pjesët e neutralitetit dhe objektivitetit. Shkruani në tabelë faktorët kryesorë të punëtorit humanitar gjatë dhënies së asistencës.: *ndihma dhe mbrojtja atyre që kanë nevojë.*

Procesi i rastit për studim

Rastet shpërndahen dhe lexohen me zë nga pjesëmarrësit. Dilema etike duhet të identifikohet nga pjesëmarrësit. Debati duhet të përqendrohet në afaktin nëse orvatja humanitare duhet të vazhdojë duke marrë parasysh dilemat e shfaqura.

A. Ajencitë e ndihmës shpëtuan civilët e pashpresë në një rajon të luftimeve të ashpra. Pasi që agjencite ofruan mbështetje nga jashtë për mbijetesën e civilëve, grupet të cilat ishin duke e bërë luftën mund t'i injoronin nevojat e civilëve të tyre. Ndhimë nga jashtë u mundësonte atyre që t'i shfrytëzonin të gjitha burimet e vendit për t'i frunizuar ushtarët e tyre. Dhe kjo ndihmonte që mos të përfundonte lufta.

➤ **A po e zgjasim ne luftën?**

B. Civilët kishin ikur në një Zonë të Mbrojtur e cila ishte bërë si një parajsë për viktimat e “pastrimit etnik” në vendin e tyre. Nga zona, punëtorët humanitarë u ndihmonin që të evakuoheshin në qendrat e refugjatëve jashtë vendit. Ky veprim humanitar në këtë mënyrë i kontribuonte pastrit etnik dhe zhvendosjes së viktimave nga vendi i tyre.

➤ **A i asistojmë ne politikat e ndarjes etnike?**

C. Dy vende janë në luftë, dhe dëmet në mes popullatës civile janë tejet të mëdha. Disa zëra nga shtetet e tjera e qortojnë gjendjen e vështirë të viktimave, por asnjë qeveri e huaj nuk është e gatishme për të intervenuar apo që t'i bëjë bashkë palët luftuese që ta ndalojnë presionin e tyre dhe ta kursejnë popullatën civile. “Çka do të thotë që të tentohet të silllet asistenca humanitare kur e dini shumë mirë se do të jetë vetëm një ‘pikë uji në oqean’ dhe se pa presion të jashtëm politik apo intervenim ushtarak, ne organizatat humanitare mund të ofrojmë vetëm ndërgjegje për botë?” Keqardhje e një punëtori humanitar.

➤ **A ofron veprimi humanitar pretekst të mospërfshirjes për politikanët?**

D. Për ta futur nën kontroll një fshat që luftëtarët kryengritës e kanë përdorur si çerdhe, në një zonë të luftimeve civilët ishin detyruar që të zhvendoseshin në një kamp, 30 kilometra nga shtëpitë e tyre. Nga agjencionet e ndihmës humanitare ishte kërkuar që t'u dërgojnë ushqim dhe asistencë mjekësore në kamp. Dukë bërë kështu, megjithatë, do të miratonim zhvendosjen me forcë të civilëve.

➤ **A jemi duke e miratuar zhvendosjen me forcë të civilëve?**

Për t'u ndihmuar pjesëmarrësve që të mendojnë për këto situata, instruktori duhet të pyesë nëse mosveprimi në këto situata është një alternativë e vlefshme.

Vlerësim

Dhjetë minuta në fund të sesionit duhet t'i kushtohen vlerësimit të marrë nga grupi se çka u ka pëlqyer dhe çka jo në lidhje me diskutimin. Në qoftë se gjatë diskutimit janë bërë pyetje të tjera për punën e organizatave të veçanta, ato duhet të shënohen dhe mund të formojnë bazë për një detyrë të re.

Këshilla metodologjike:

Ky aktivitet mund të jetë frustrues për pjesëmarrësit pasi ata nuk do të marrin asnjë përgjigje të qartë. Është me rëndësi se analiza përqendrohet nga prespektiva e punëtorit

humanitar dhe se pjesëmarrësit gjithmonë i referohen mbrojtjes dhe ndihëms për ata që kanë nevojë si dhe parimeve të neutralitetit dhe objektivitetit. Nëse ky diskutim ka dalë nga këto pika, instruktori mund të theksojë faktin se ka shumë akterë në konfliktin e armatosur veprimet e të cilëve i pengojnë ato të punëtorëve humanitar.

Sygjerime për ndryshim

Pas diskutimit, disa pjesëmarrës do të pyeten që të veprojnë në këto situata:

Një punëtorë humanitar po qëndron në dyert e një kampi të refugjatëve. Ai është përballur me një familje që do të hyjë në kamp, frikohet nga armiqtet brenda kampit. I ati kërkon që ta mbajë revolen e tij për t'i mbrojtur gruan e sëmurë dhe foshnjen e tij. Familja po ashtu tmerrohet në qoftë se ndahet.

Pasi ta luajnë skenarin, pjesëmarrësit duhet të diskutojnë parimet të cilat punëtori humanitar duhet t'i marrë parasysh, dhe nëse disa parime bien në kundërshtim me të tjerat në këtë situatë.

PJESA IV: VAZHDIMI

Fusha të tjera të hulumtimit

A përballen aktivistët për të drejtat e njeriut me dilemën etike gjatë kryerjes së punës?

BURIMI

HULUMTIMI I TË DREJTËS HUMANITARE, MODULET EDUKATIVE PËR TË RINJ, KNKK 2002, FQ.359.

BIBLIOGRAFIA

Antonie Bouvier. 2000. *E Drejta Ndërkombëtare Humanitare dhe e Drejta e Konflikteve të Armatosura*, Lëndë e Mësimi nga Distanca e Disenjuar për Institutin për Trajnim dhe Hulumtim të Kombeve të Bashkuara, UNITAR POCL.

Gjej KNKK, KNKK Maj 2002

Në dispozicion në:

http://www.icrc.org/web/eng/siteeng0.nsf/ièpList2/About_the_ICRC:Discover_the_ICRC

Dunant Henry. 1986. *Kujtimi i Solferinos*. KNKK.

KNKK.2001. *Të drejta e njeriut dhe KNKK*, E drejta ndërkombëtare humanitare, KNKK korrik 2001.

KNKK.2002. *Njohja e të Drejtës Humanitare. Modulet e edukimit për të rinj*. KNKK.

KNKK.2002. *E drejta Ndërkombëtare Humanitare: Përgjigjet për pyetjet tuaja*. ICRC.

Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq:

<http://www.icrc.org>

INFORMATAT PLOTËSUESE

Action contra la Faim (ACF): <http://www.av\ct-fr.org>

CARE International: <http://www.care.org>

Caritas Internationalists: <http://www.caritas.org>

Konferenca e OJQ-ve në Marrëdhëniet Konsultative me Kombet e Bashkuara (CONGO): <http://www.ids.ac.uk/eldis/data/d021/e02162.html>

Komiteti për Urgjencë të Sëmundjeve (KUS):

<http://www.dec.org.uk>

Zyrja Humanitare e Bashkësisë Evropiane (ZHBE):

http://europa.eu.int/comm/echo/index_en.htm.

Dieter Fleck. 1999. Doracaku për të drejtën humanitare në konflikte e armatosura.

Handicap International:

<http://www.handicap-international.org>

InterAction: <http://www.interaction.org>

Këshilli Ndërkombëtar i Agjencioneve Vullnetare (KNAV):

<http://icva.ch>

Banka Zhvillimore NdëraAmerikane (BZhN):

<http://www.iadb.org>

Inicativa Hulumtuese e të Drejtës Ndërkombëtare Humanitare:

[www.//www.ilhresearch.org/portal/ihli/portalhome.php](http://www.ilhresearch.org/portal/ihli/portalhome.php)

International Save dhe Children:

<http://www.savethechildren.net>

Komiteti i Ndërlidhjes se Zhvillimit të OJQ-ve të Bashkimit Evropian:

<http://www.ids.ac.uk/eldis/data/d021/e02162.html>.

Hilarie Mac Coubrey. 1990. E Drejta Ndërkombëtare Humanitare. Rregullat e konflikteve të armatosura.

Mjekët e Botës / Medecins Du Mond:

[www.//www.medecinsdumonde.org](http://www.medecinsdumonde.org)

Medecins sans Frontieres (MSF) / Mjekët Pa Kufij (MPK):

<http://www.msf.org>

Forumi i mijëvjeçarit të OJQ-ve:

<http://www.millenniumforum.org>

Organizata e Unitetit Afrikan (OAU):

<http://www.africa-union.org/fr/home.asp>

Organizata e Shteteve Amerikane (OshA):

<http://www.oic-oic.org>

OXFAM: <http://www.oxfam.org>

Renaë Provost. 2002. Të drejtat e nderkombëtare të njeriut dhe e drejta humanitare.

Save dhe Children – UK:

<http://www.savethechildren.org.uk>

The Food and Agriculture Organization (FAO) – Organizata e Ushqimit dhe e Bujqësisë (OUB)

<http://www.fao.org>

Zyra e Komisionerit të Lartë për Refugjatë e Kombeve të Bashkuara (UNHCR):

<http://www.unhcr.ch>

Departamenti i Misioneve Paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara (DMPKB / UNDPKO):

<http://www.un.org/depts/dpko/dpko/home.shtml>

Komisioneri i Lartë për të Drejtat e Njeriut i Kombeve të Bashkuara (KLDNKB / UNHCHR): <http://www.unchr.ch>

Zyra e Koordinatorit për Çështje Humanitare të Kombeve të Bashkuara (ZKKBQH):

http://www.reliefweb.int/ocha_ol

Programi Botëror i Ushqimit (PBU): <http://www.wfp.org>

Oragnizata Vullnetare për Kooperim në Kriza (OVKK): <http://www.ngovoice.org>

World Vision International: <http://www.wvi.org>